



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

(Specialist)

**Lloji i diplomës “SHKENCA HUMANE, SHKENCA SOCIALE, MESUESI,
SHENDET PUBLIK etj.”**

Niveli minimal i diplomës “DIPLOME E NIVELIT TE PARE”

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave (I ndryshuar), “Per pranimin, levizjen paralele, periudhen e proves dhe emerimin ne kategorie ekzekutive” **Bashkia Roskovec** shpall procedurat e levizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- ❖ 1(nje) Specialist i menaxhimit te Projekteve Sociale dhe Kordinatore me BE-ne.

Bashkia Roskovec;

Shpallja eshte e hapur per te gjitha nepunesit civil te se njejtës kategori ne te gjitha institucionet pjese e shërbimit civil. Nese nuk ka nje fitues nga procedura e levizjes paralele, plotesimi i vendit vakant do te realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (levizje paralele dhe Pranimi në Shërbimin Civil në kategorie (ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

LEVIZJE PARALELE: 10 shkurt 2021

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 15 shkurt 2021

Përshkrim i Përgjithshëm

Njesia e Menaxhimit te Projekteve Sociale për administrimin e çështjeve që lidhen me promovimin e vlerave të territorit me qëllim nxitjen e donatoreve, vendas apo të huaj, forcimin e

bashkëpunimit me partner të huaj dhe vendas me qëllim implementimin, menaxhimin, mbikqyrjen dhe koordinimin e projekteve të ndërrmarra me qëllim përmbushjen e interesave ekonomikë, social, kulturorë apo sportiv të njësisë së qeverisjes vendore si dhe ofrimin e shërbimeve dhe lehtësimin e procedurave për të gjithë donatorët apo investitorët të huaj apo vendas, që ndërrmarrin iniciativa në territorin e bashkisë. Gjithashtu, Njesia e menaxhimit të projekteve sociale është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për strukturat në varësi, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës

DETYRAT

Detyrat Kryesore

Ka varësi direkte nga përgjegjësi I sektorit të menxhimit të projekteve sociale dhe koordinator me BE-ne.

Specialisti ka keto detyra:

- Identifikon projekte strategjike, që do të përmirësonin cilësinë e jetesës së qytetarëve të Roskovecit;
- Përgatit termat e referencës për projektet;
- Bashkëvepron me departamente të tjera për inpute të ndryshme për projekte të reja sociale
- Evidenton problemet që dalin nga veprimtaria e përditshme si dhe përcakton zgjidhjet e mundshme Brenda kuadrit ligjor në fuqi;
- Administron dhe jetëson projekte prioritare të Bashkisë në bashkëpunim me drejtoritë e bashkisë dhe institucionet e varësisë, sipas natyrës së projektit;
- Në bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse, mbikqyr zhvillimin e plotë të projektit shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
- Përcakton hapat e nevojshme që duhen ndërmarrë dhe kalendarit të zhvillimit të projekteve;
- Përcakton rolin që duhet të luajnë drejtoritë përgjegjëse në realizimin e këtyre aktiviteteve;
- Mbikqyr realizimin aktivitetive të aktiviteteve në bazë të afateve kohore të përcaktuara;
- Në bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse bën vlerësimin financiar dhe caktimin e termave të referencës për projektet që i janë caktuar;
- Përfaqëson Bashkinë në bisedime me palë të treta për projektet që i janë caktuar;
- Mbikqyr realizimin e punës për projektet e tjera dhe raporton për ecurinë e tyre

I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këto pozicione janë:

- a) te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare, Diplomë “Bachelor”, në Shkenca Sociale, Shkenca Humane, Shendet Publik, Mesuesi. Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) te kete te pakten 1 vit punë.
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorise Juridike dhe te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave.Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje e vleresimit të fundit vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **10.02.2021**

Rezultatet nga verifikimi paraprak te kushteve minimale te procedures se levizjes paralele dhe te permbushjes se kriterëve specifike te vendit te punes do te dalin ne daten **12.02.2021** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin,në portalin ”Sherbimi Kombetar i Punesimit”, në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisëdhe në stendën e informimit te publikut.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit te Burimeve Njërëzore, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Njësine e Menaxhimit te Burimeve Njërëzore, brenda **3 diteve** kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr pergjigje brenda **5 diteve** kalendarike nga data e perfundimit te afatit te ankimeve.

Pas perfundimit te procedures se siperpermendur nepunesi me i larte civil i institucioniot bnrenda dy diteve kalendarike urdheron ngritjen e komisionit te brendshem.

Komisioni i brendshem brenda 2 (dy) diteve kalendarike nga data e krijimit te tij, zhvillon intervisten me goje.

Intervista me goje do te zhvillohet ne ambjentet e Bashkise Roskovec me datë

24.02.2021 ora 11:00.

Ne interviste kandidatet do te vleresohen per njohurite e tyre ne keto fusha:

- Ne baze te ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore” neni 9 pika 1.1 shkronja ‘c’, 10,11,12, dhe pika 3;
- Ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.450, date 26.07.2018 “Per bashkerendimit dhe koordinimin e procesit te integritit europian, ndermjet qeverisjes qendrore dhe njesive te vetqeverisjes vendore”, pika 1;etj

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshem për Lëvizjen Paralele i ngritur nëBashkine Roskovec**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv.
- b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, rendit kandidatet sipas pikeve te grumbulluara dhe I dergon listen njesise se burimeve njerezore te institucionit. Njesia e burimeve njerezore e institucionit, brenda 24 oreve nga dita qe komisioni i njofton vendimin e tij, njofton individualisht kandidatet qe kane konkuruar per rezultatin e tyre. Kandidatet, pavaresisht nga e drejta per tu ankuar kane te drejte te bejne ankim me shkrim dhe ne komisionin e brendshem per levizjen paralele per rezultatin e vleresimit, brenda 3 (tre) diteve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesei merr pergjigje brenda 3 (tre) diteve kalendarike nga data e perfundimit te afatit.

Njoftimi do të bëhet:

1. në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
2. në faqen zyrtare të Bashkise
3. ne stenden e publikimeve te Bashkisë Roskovec.

II- Pranimi në Shërbimin Civil.

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë e ekzekutive.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotrojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar(hequr) sipas këtij ligji.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- a) te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degët “Shkenca Sociale, Shkenca Humane, Mesuesi, Shendet Publik”. Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) te kete te pakten 1 vit punë.
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovec këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave.Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Rezultatet nga verifikimi paraprak te kushteve minimale te procedures e pranimit në shërbimin civil dhe te permbushjes se kriterëve specifike te vendit te punes do te dalin ne daten **04.03.2021** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, ne portalin ”Sherbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerezore për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njërëzore, brenda 5 diteve kalendarike nga dhe ankuesi merr pergjigje brenda 5 diteve kalendarike nga data e perfundimit te afatit te ankimit.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me goje, do te zhvillohet ne ambjentet e Bashkise Roskovec në datën **18.03.2021 ora 10:00.**

Ne konkurimin me shkrim dhe intervisten e strukturuar me goje, kandidatet do te vleresohen per njourite e tyre ne keto fusha.

- Ne baze te ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore” neni 9 pika 1.1 shkronja ‘c’, 10,11,12, dhe pika 3;

- Ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.450, date 26.07.2018 “Per bashkerendimit dhe koordinimin e procesit te integrimit europian, ndermjet qeverisjes qendrore dhe njesive te vetqeverisjes vendore”, pika 1;etj

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "*Specialist i menaxhimit te Projekteve Sociale dhe kordinatore me BE-ne*"

Komiteti i Përhershëm i Pranimit brënda 24 (njëzet e katër) orëve, pra në date **19.03.2021** njofton listen e fituesve, Njesise pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore më date **02.04.2021** , shpall listen e fituesve.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- ne stenden e informimit publik.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne adresen Bashkia Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : olta.brahushi@bashkiaroskovec.gov.al

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE